

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haxhiu pas vendimit në Hagë: Një ditë e rëndë për Kosovën, historia e saj nuk rishkruhet nga asnjë aktgjykim
ADRESA	https://albeu.com/kosove/haxhiu-pas-vendimit-ne-hage-nje-dite-e-rende-per-kosoven-historia-e-saj-nuk-rishkruhet-nga-asnje-aktgjykim/1014144/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:42:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:38:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4b5fac20b8e997bd7ae9c661005bd7a24dfa0412f8d281da0f6a98866e600af9
TEKSTI	9397af2e5e2cd3f4218896e7ff147a5acc23e543b02821641632659f9c412fd6
PAMJA	13e6f6963e2336f6fdcc3cd6bd223a623ab2abe3ee715171b96b6de1096eabcc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6e2e4b7fcd2e3434c4173763992700d0676d083ea2700f8e52d1945b93ba9ec6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bff0934ba4720654b865868030
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6e2e4b7fcd2e3434c4173763992700d0676d083ea2700f8e52d1945b93ba9ec6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Haxhiu pas vendimit në Hagë: Një ditë e rëndë për Kosovën, historia e saj nuk rishkruhet nga asnjë aktgjykim



Kryetarja e Kuvendit të Kosovës dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi.

Ajo i ka cilësuar dënimet e shqiptuara si një goditje të rëndë për familjet e tyre, ndërsa vendimin e ka përshkruar si lajm thellësisht tronditës për Republikën e Kosovës dhe si një moment të rëndë për kombin shqiptar.

Haxhiu ka shprehur solidaritetin e saj me familjet e Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit, të cilat, sipas saj, prej vitesh po përballen me mungesën, pritjen dhe pasigurinë. Ajo u ka bërë thirrje që të qëndrojnë të forta, duke rikujtuar se procesi gjyqësor nuk përfundon me aktgjykimin e shkallës së parë, pasi palët kanë të drejtë ankese. Reagimi i saj është përcjellë nga "Bota sot".

Kryetarja e Kuvendit ka kërkuar gjithashtu që këto dënime të mos shfrytëzohen për të relativizuar krimet e regjimit të Serbisë gjatë luftës në Kosovë. Në këtë periudhë, ajo ka bërë thirrje për qetësi, dinjitet dhe bashkim.

Në reagimin e saj të plotë, Haxhiu ka deklaruar se vendimi dhe dënimet ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit përbëjnë një goditje të madhe për familjet e tyre, një lajm tronditës për Kosovën dhe një çast të rëndë për shqiptarët kudo që jetojnë.

Ajo ka theksuar se pesha e vendimit të sotëm duhet parë në lidhje me historinë e Kosovës, e cila ka përjetuar dhunën e një aparati shtetëror që vrau civilë, kreu masakra, dëboi qindra mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre dhe la pas mijëra të vrarë e të zhdukur. Sipas Haxhiut, kjo përvojë mbetet pjesë e pashlyeshme e kujtesës së Kosovës dhe të kombit shqiptar.

të fundit /



Haxhiu pas vendimit në Hagë: Një ditë e rëndë për Kosovën, historia...



Vëllai i Kadri Veselit: Procesi nuk ishte i drejtë, duhet ta...



Koci pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së: Procesi juridik nuk ka...



Ganiu Thaçi pas vendimit për Hashim Thaçin: Do të presim...



Avni Islami u kërkon qytetarëve qetësi dhe unitet pas vendimit të...



Babai i saj u dënua me 25 vite burg, reagon vajza e Jakup Krasniqi...



Ardian Gjini i cilëson "tronditëse" dënimet e Gjykatës Speciale nd...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Mendimet e mia janë, para së gjithash, me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Prej vitesh ato mbajnë barrën e mungesës, pritjes dhe pasigurisë. Dënimet e sotme e bëjnë këtë barrë edhe më të rëndë", ka thënë ajo.

Haxhiu u ka përcjellë familjeve një mesazh nga Kosova, duke u kërkuar të qëndrojnë të forta dhe duke u siguruar se Kosova është me to. Ajo ka nënvizuar se fjala e fundit juridike ende nuk është thënë dhe se e drejta e ankimit, si pjesë e procesit, duhet të ushtrohet plotësisht.

Ajo ka mbrojtur karakterin çlirimtar të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke thënë se ajo lindi përballë shtypjes, dhunës dhe krimeve të regjimit të Serbisë ndaj popullit të Kosovës. Sipas saj, asnjë aktgjykim nuk mund ta ndryshojë natyrën e asaj lufte apo ta zhbëjë të drejtën e një populli për të luftuar për lirinë e vet.

"Respekti për drejtësinë nuk nënkupton heshtje përballë çdo përpjekjeje për ta shtrembëruar historinë. Nuk duhet lejuar që dënimet e sotme të përdoren për të relativizuar krimet e regjimit të Serbisë, për ta zvogëluar përgjegjësinë për to apo për të krijuar një narrativë të rreme", ka deklaruar Haxhiu.

Ajo ka thënë se këtë qartësi e pret edhe nga miqtë dhe aleatët e Kosovës.

"Sot na duhet qetësi, dinjitet dhe bashkim. Dhimbja e kësaj dite nuk duhet të na ndajë", është shprehur ajo.

Haxhiu ka përfunduar duke thënë se Republika e Kosovës do ta kalojë edhe këtë sprovë, duke mbetur besnike ndaj drejtësisë, lirisë dhe së vërtetës së saj. Sipas saj, aktgjykimet nuk mund ta gjykojnë historinë e një populli dhe as ta rishkruajnë atë.

Shtuar më 16.09.2026 12:38

Tags: [denime](#), [Hagë](#), [Kryetarja e Kuvendit të Kosovës](#)
dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, [reagim](#),
[Vendim](#)



Lladrovci: Aktgjykimi ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së e shndërroi drejtësinë në...



Vëllai i Kadri Veselit: Procesi nuk ishte i drejtë, duhet ta pranojmë vendimin



Koci pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së: Procesi juridik nuk ka përfunduar



Ganiu Thaçi pas vendimit për Hashim Thaçin: Do të presim Apelin



Avni Islami u kërkon qytetarëve qetësi dhe unitet pas vendimit të Hagës



Babai i saj u dënua me 25 vite burg, reagon vajza e Jakup Krasniqit:...



Ardian Gjini i cilëson "tronditëse" dënimet e Gjykatës Speciale ndaj is...



Qytetarët në Hagë marshojnë drejt Gjykatës Speciale, forca të shtuara...

albeu

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

[Erion Veliaj](#)
[Free Esim](#)
[Zgjedhjet 2025](#)
[Belinda Balluku](#)
[SPAK](#)
[Kombëtarja](#)

Kategori

[Lifestyle](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Shëndetësi](#)
[Argetim](#)
[Enciklopedi](#)

Linqet

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Tags

[Edi Rama](#)
[Albania News](#)
[Ilir Meta](#)
[Piranjat](#)
[gazeta, tv, portale](#)

Moti

[Moti në Tiranë](#)
[Moti në Prishtinë](#)
[Moti në Shkup](#)
[Moti në Durrës](#)
[Moti në Prizren](#)
[Moti në Tetovë](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.